

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e All-llahut dhe mos u përcani” (Ali-Imran 163)

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkoder
Vitet I i botimit, Nëntor 2007 Nr 7. Çmimi 20 lekë.
Www.gazetabesimtari.com; e-mail: info@gazetabesimtari.com

Krveredaktor Selim Gokaj



HIQET NGA KARTA E IDENTITETIT FIGURA E NENE TEREZES

KRYEMINISTRI DEMOKRAT SALI
BERISHA KERKON NDIHMEN E
KONFERENCES ISLAMIKE
PER PAVARESINE E KOSOVES

Selim Gokaj

NJE MNISTER LUFTENXITES I
QEVERISE DEMOKRATIKE

Selim Gokaj

Fq 2

TOLERANCA E PERANDORISE
OSMANE DHE MARRDHENIET E
SHQIPTAREVE ME PERANDORINE
OSMANE

Ardit Muça

Fq 3

OSMAN NURI TOPBASH
NE MES TE VELLEZERVE
TE TIJ SHQIPTARE

Selim Gokaj

Fq 4

RILINDJA FETARE

Faik Miftari

A ËSHTË SHAMIA SULM MBI
VLERAT DEMOKRATIKE?

Nexhat Ibrahim

Fq 5

HAFIZ YMER BAKALLI -
DIJETAR DHE PATRIOT

Fq 7

Mediat kombëtare dhe ato lokale kanë njoftuar se qeveria demokratike ka hequr nga karta e identitetit të shqiptarve figurën e Nënë Terzës duke i dhënë një varjan të ri të kartës së identitetit, ku do të jetë vetëm figura e personit që do të marrë kartën e identitetit.

Rruga e gjatë që ndoqi karta e identitetit e shqiptarve për të përfunduar me varjantin pa figura fetare, është e lidhur me udhëzimet e çuditshme të qeverisë demokratike për të cënuar karakterin laik të shtetit shqiptar, identitetin e muslimanëve që janë shumicë dhe mbi gjithshka, karta me figura fetare cënonte tolerancën fetare në Shqipëri. Duket se deklaratat Forumit Musliman të Shqipërisë, letra e avokatit të popullit drejtuar qeverisë demokratike për këtë çështje, protesta e ish-kryetarit të Këshillit të Përgjithshëm të KMSH dhe mbi gjithshka, deklaratat e shoqatave muslimane të Shkodrës e detyruan qeverinë demokratike që të rishikojë vendimin e saj për të vënë një figure fetare në kartën e identitetit të shqiptarve dhe të jape përfundimisht një model të ri të kartës e cila respekton Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë që sanksionon karakterin laik të shtetit shqiptar. Në njoftimin saj, qeveria deklaroi se ky veprim u ndërmor që të respektoheshin besime dhe grupe të ndryshme qytetarësh. Nuk dime se kush e rekomandoi dhe kush e aprovoi atë kartë

identiteti me figura fetare dhe kush i dha asaj një pamje ligjore duke u përpjekur që të krijojë situata të panevojshme tensioni fetar në

Shqipëri. Qeveria demokratike duhet të vërë para përgjegjësisë fajtorët, sepse faji në rastin e kartës së identitetit të shqiptarve është shumë specifik përse i përket demit që mund të sillte në acarimin e raportet fetare në Shqipëri

Ne dëshrojmë që qeveria demokratike të heqë dorë nga veprime të tilla, sepse nuk mundojnë këshilltarët pranë qeveritarëve, por që edhe këto këshilltarë duhet të kalojnë në sitën e vlerave kombëtare dhe fetare të popullit shqiptar dhe mos të na

bëjnë të mendojmë për prapavija që fshehen dhe

veprojnë pas tyre. Mendojmë se karta e re e identitetit të shqiptarve është një arritje e bashkëjetesës fetare të cilën duhet ta ruajmë si një vlerë të paarrtshme të popullit shqiptar. Dhe duhet të mos harrojmë se qeveria shqiptare duhet të jetë barrkadë e pakalueshme për ato që përpiqen të shkatërrojnë bashkëekzistencën fetare në Shqipëri. Dhe kur ato godasin nga pozicionet shtetërore atëherë edhe janë më të rrezikshëm dhe për pasojë edhe goditjen do ta kënë më të rëndë nga qytetarët shqiptarë që duan të jetojnë në paqë e qetësi.

Haxhi Vebi Dani Shkodër, me 9 nëntor 2007

KRYEMINISTRI DEMOKRAT SALI BERISHA KERKON NDIHMEN E KONFERENCES ISLAMIKE PER PAVARESINE E KOSOVES

Kryeministri Sali Berisha bëri një lëvizje të rëndësishme për çështjen e Pavarësisë së Kosovës dhe njohjen e Pavarësi së njëanshme të saj në se dështojnë bisedimet për Statusin e Kosovës. Kështu i filluan lajmet mediat shqiptare, duke komentuar vizitën e Kryeministrit demokrat, Sali Berisha, në Egjipt, vizitë që na kujtoi vizitat e dikurshme që bënte Sali Berisha në vendet muslimane kur erdhi në pushtet Partia Demokratike në vitin 1992. Në ato vite kryeministri Berisha mendonte me të drejtë se lidhjet me vendet muslimane kishin një rëndësi të veçantë për Shqipërinë, sepse pjesa kryesore e shqiptarve kishte popullsi muslimane dhe deviza e fesë islame është se muslimanët janë vëllezër në të gjithë hapësirat, ku ato jetojnë. Duket se Berisha e njihte mire këtë devizë të fesë islame dhe u hapi dritën jeshile shoqatave muslimane që të vepronin të lira, por duke respektuar ligjet e shtetit shqiptar. Sali Berisha bëri edhe hapin vendimtar për të lidhur Shqipërinë, me popullsi muslimane, me Konferencën Islamike duke e bërë Shqipërinë anetare të Konferencës Islamike. Por, ky akt i qeverisë demokratike nuk ishte në një linjë me planet e opozitës socialiste dhe të miqve perendimorë të Shqipërisë të cilët reagueshëm ashpër dhe e panalizuan mediatikisht dhe diplomatikisht anëtarësimin e Shqipërisë në Konferencën Islamike. Drejtuesit e Partisë Socialiste garuan me njëri tjetrin duke vjellur helm kundër qeverisë demokratike që, sipas tyre e largoi Shqipërinë nga Perëndime dhe e çoi në Lindjen Muslimane, thuajse atje nuk jetonin njerëz, por egërsira. Socialistët, kur thonin



Perëndimi, kishin parasysh Greqinë, sepse me sa dukej "ato e merrnin bukën në furrën greke" Mediat shqiptare "dolën krejt nga shinat "duke filluar një fushatë të egër antiislame që na bind se edhe ato "e merrnin bukën në një furrë si socialistët"

Por, tashmë hapësirat gjeostrategjike kanë ndryshuar dhe po prekin direkt edhe Shqipërinë duke e detyruar politikën shqiptare të hedhë vështrimin edhe nga Lindja, sepse ajo e kuptoi

që edhe atje Shqipëria ka miq potencialë.

Kryeministri demokrat, Berisha, gjatë vizitës në Egjipt i kërkoi ministrit të jashtëm egjiptian, Abdyl Geit që të ndikojë tek vendet e Konferencës Islamike që ato ta njohin në bllok Pavarësinë e njëanshme të Kosovës, në se dështojnë bisedimet për Statusin Kryeministri shqiptar ia kërkoi ndihmën për Kosovën vendeve që ai duhet t, ua kërkonte pa ndërmjetës. Por, politika shqiptare dhe në veçanti qeveria demokratike, ka bërë dhe po bën gjynahe të rënda ndaj Botës Islame, duke dërguar trupa ushtarake në fushëbeteja ku vriten muslimanë të pafajshëm, ku po dhunohen djemtë dhe vajzat muslimane, sepse ato duan të qeverisen vetë, të jetojnë të lire në token ku kanë lerë dhe ku ato jetojnë Ne jemi të bindur se vendet e Konferencës Islamike do të njohin në bllok Pavarësinë e Kosovës, pavarësisht qëndrimit që po mban politika shqiptare ndaj Botës Islame, sepse këto vende e kanë detyrë të mbështesin popullin vëlla dhe musliman të Kosovës, si e mbështetën gjatë luftës së fundit, kur kosovarët u bënë viktima të genocidit serb. Tashmë, politikanët shqiptarë, të cilëve është e vështirë t, ua dallosh ngjyrën, duhet ta kenë kuptuar se edhe në Lindjen Muslimane jetojnë njerëz që kanë potenciale në të gjitha fushat, se dhe atje ka zhvillim e progress, se edhe atje ka arritje, ndaj të cilave, Perëndimi i përparuar e ndjen vehten të prapambetur.

*Selim Gokaj
Shkodër, me 2 nëntor 2007*

Nje minister luftenxites i qeverise demokratike



Në një emision, që organizon kanali televiziv Top Kanal, i cili drejtohet nga gazetari Mustafa Nano, ishte i ftuar ministri i qeverisë demokratike, Gjergj Bojaxhi, i cili, si të gjithë ata që janë të ftuar në këtë emision, komentoi figurat që dilnin në monitor njëra pas tjetrës. Gjatë këtij emisioni, ne u befasuam kur morëm vesh se një qytetar

amerikan ishte ministër në një qeveri shqiptare, megjithëse Bojaxhiu shtoi se ai ka edhe shtetësi shqiptare duke qenë kështu një person me dyshetësi. Dyshetësia e ministrit Bojaxhi na kujtoi akuzat e ashpra që u bënë kohë më parë kundër ish-presidentit Berisha që u kishte dhënë dyshetësi disa personave që vnin nga bota islame. Nuk e dime se kush ia ka dhënë ministrit Bojaxhi këtë dyshetësi, por pa tjetër duhet të jenë dhënë me ato parametra që janë në një linjë

me politikën që dominon sot në hapësirën shqiptare. Ministri pohoi se ishte anëtar i Partisë Republikane Amerikane (Nuk dime nëse është edhe anëtar i Partisë Demokratike, apo përfaqëson atë që quhet Shoqëria Civile). I ftuari në emision pohoi se në zgjedhjet e para presidenciale kishte votuar për Xhorxh Bushin,

kurse në zgjedhjet e dyta presidenciale, që i dhanë Bushit mandatin e dytë presidencial, amerikan, Gjergj Bojaxhi, kishte votuar kundër Bushit.

I pyetur nga gazetari, që drejtonte emisionin, për qëndrimin e ministrit Bojaxhi ndaj luftës në Irak, ministri tha se ai kishte qenë kundër luftës së amerikanëve në Irak.

Duke e vazhduar përgjigjen ai deklaroi në mënyrë të papritur se, me që trupat amerikane tashmë kanë hyrë në Irak, ato duhet ta përfundojnë misionin e tyre. Ishtenjë pohim që pa tjetër i ka tronditur ato që e ndoqën në ekran ministrin që duket se nuk e di që kundër luftës, që bëjnë amerikanët në Irak, sot demostrojnë në të gjithë botën duke kërkuar që amerikanët të largohen nga Iraku për t, i dhënë fund dhunës dhe vrasjeve që po sjellin çdo ditë viktima të pafajshme.

Kurse, ministri jonë amerikano-

shqiptar është për vazhdimin e një lufte, që në fakt është e humbur. Ai nuk ka kundërshtim që të vazhdojnë vrasjet dhe krimet kundër civilëve, të vazhdojnë edhe përdhunimet për të cilat po dënohen, në një cikël të pandërprerë, ushtarë amerikanë, britanikë e shumë të tjerë nga kombësi të ndryshme që po tregojnë moralin e tyre të ulët Z. ministër! Lufta, në një territor të një shteti të pavarur, është luftë pushtuese dhe ju e dini mire këtë fakt. Ju duhet ta dini se nxitja e vazhdimin të kësaj lufte do të thotë se duhet të vazhdojë të rriten flakët e luftës dhe për pasojë të rritet edhe numuri i viktimave të pafajshme. Do të dëshëronim të të shihnim në një emision tjetër televiziv, ku ju të shpreheni se jeni kundër luftës në Irak duke u bërë kështu pjesë e forcave të Paqes në të gjithë botën.

*Selim Gokaj
Shkodër, Me 20 Tetor 2007*

TOLERANCA E PERANDORISE OSMANE DHE MARRDHENIET E SHQIPTAREVE ME PERANDORINE OSMANE



Pasi kishin pushtuar pothuajse gjithë Anadollin perëndimor, me kërkesën e Perandorit Bizantin, osmanët kaluan Dardanelet dhe u hodhën në Ballkan, ku shumë shpejt do të vendosnin sundimin e tyre. Ishte viti 1349, kur osmanët, për herë të parë kaluan në Europë. Vetëm për një kohë të shkurtër, ata arritën të shtrinin pushtetin e tyre në një hapësirë shumë të gjërë. Kjo i trembi popujt ballkanas dhe sidomos mbretëritë serbe, bullgare e boshnjake si dhe princat shqiptarë, të cilët, me anë të koalicioneve të njëpasnjëshme u munduan të dëbonin osmanët nga Ballkani, por nuk ia arritën këtij qëllimi. Sulltanët e parë osmanë e shtrinë sundimin e tyre, në më pak se 150 vjet, në gjithë Ballkanin, Ballkanasit ishin shumica dërrmuese të krishterë ortodoksë. Kjo fe kishte një përhapje të tillë për shkak të sundimeve të egra të perandorive ortodokse të Bizantit, Serbisë e Bullgarisë. . Megjithë koalicionet e njëpasnjëshme ballkanase, osmanët u forcuan gjithnjë e më tepër. Kur vdiq sulltan Mehmet II, Fatihu edhe Shqipëria, territori i fundit jashtë sundimit osman në Ballkan, ishte pushtuar. Osmanët, që në fillim kanë pasur një politikë tolerante, që i mundësonte osmanëve të pranonin në gjirin e tyre edhe popuj të tjerë. Ata i respektonin traditat vendase dhe në shumë rajone ato lanë një gjendje autonomie. Në Shqipëri ka pasur disa krahina të tilla autonome ku përmendim, Malësinë e Mirditës, Dibrën, Himarën, Shpatin, Sulin. Këto krahina nuk prekeshin nga ligjet, apo sundimi osman, por kishin detyrime ndaj sulltanit kryesisht ushtarake. Në qoftë se sulltani i thirrte të luftonin për të, ata duhej t'i përgjigjeshin.

Politikën tolerante e osmanëve ishte edhe ingranimi i princave të krishterë në postet drejtuese osmane. Osmanët krijuan një sistem të tillë, sipas të cilit djemtë e krishterë vendas i edukonte në pallatet e sulltanit dhe në të ardhmen ata bëheshin pjesë e udhëheqjes së Perandorisë. Kryesisht ata zinin poste në ushtri. Kjo ka ngjallur shqetësimin e muslimanëve të Perandorisë, cilët nuk ishin dakort me këtë sistem. Në gjysmën e parë të Perandorisë

Osmane, do të ishte ky sistem që do t'i jepte Perandorisë pjesën dërrmuese të vezirëve të mëdhenj dhe të funksionarëve të tjerë të shtetit. Në këtë sistem shpesh edukoheshin princat e feudalëve vendas, të cilët i kishin premtuar besnikëri sulltanit. Por, sulltani, duke parë kryengritjet e shpeshta që bëheshin sapo t'i paraqitej mundësia, vendosi që të merrte djemtë e tyre si garanci.


Kjo politikë e sulltanit ishte më e përparuar se e mbretërive dhe perandorive tjera të asaj kohe. Asnjë mbretëri, as Franca, as Anglia, as Perandoria e Shenjtë Romake, nuk ndiqnin politikë të tillë. Ato vendosnin menjëherë pushtetin direkt duke mbytur popullsinë në taksa dhe as që bëhej fjalë për të drejta kombëtare. Edhe kur Perandoritë Europiane ishin në kulmin e tyre, ata nuk kanë ndjekur kurrë një politikë, e cila respekton të drejtat e popujve të pushtuar. Për ilustrim kemi shfrytëzimin e zezakëve, apo indigjenëve amerikanë në minierat e arit, apo dhe skllavërimin e tyre. Përkrahjen që gëzoi kjo politikë në popujt e sunduar e shohim gjatë Luftës së Lidhjes së Shenjtë në vitet 1683-1699. Gjatë kësaj lufte, serbët dhe hungarezët, sapo iu dha rasti ngritën krye menjëherë dhe pritën krahëhapur pushtuesit austriakë. Por, nuk kaloi shumë dhe ata u penduan për këtë që bënë dhe i kërkuan ndihmë sulltanit që të vinte edhe njëherë.

Politika e ndjekur nga sulltani bëri që pjesa dërrmuese e drejtuesve lokalë të përqafojnë islamin, duke i hapur kështu rrugën një procesi tjetër, islamizimit. Shumë shpejt feja e re u përhap në qytete dhe pastaj me kalimin e kohës u shtri edhe në fshatra. Islamizimi ndodhi mjaft ngadalë dhe në shek. XIX u përshpejtua. Fillimisht Islamin e përqafojnë funksionarët, që të gëzonin privilegjet e qendrës. Pastaj e përqafojnë zejtarët, artizanët e tregtarët, që të gëzonin privilegjet e funksionarëve. Mirëpo këto grupe që e përqafojnë fenë e re ndoshta thjesht për interes, natyrisht që u interesuan sado pak për të. Ngadalë ato u afruan me institucionet fetare, me xhamitë dhe hoxhallarët, të cilët e përshpejtuan procesin e islamizimit. Njerëzit u

afruan në fenë e re pa asnjëfarë ushtrimi dhune. Megjithë këtë politikë të ndjekur nga sulltani, muslimanët përbënin shumicën vetëm të shqiptarët dhe boshnjakët. Kurse në popujt tjerë si: bullgarë, serbë, grekë, kroatë, etj. në rastin më të mirë përbënin 10% të popullatës. Ky fakt vërteton edhe njëherë se islamizimi u krye pa dhunë. Në qoftë se do të kishte pasur islamizim me dhunë, atëherë edhe popujt e lartpërmendur do të ishin në pjesën dërrmuese muslimanë.

Shumë studiues përmendin se ka pasur presion ekonomik, me taksën e xhizjes, të cilët duhej ta paguanin të krishterët, dhe e përmendin ndër shkaqet kryesore. Kjo hipotezë është pjesërisht e vërtetë. Si çdo shtet edhe Perandoria Osmane ka pasur lajthitjet e veta në fushën ushtarake, apo ekonomike. Ka pasur raste, kur nëpunësit e kanë tepruar me sasinë që kanë kërkuar, por këto kanë qenë raste spontane dhe jo të karakterit të përgjithshëm, aq më tepër që kanë qenë të rralla në lidhje me rastet e drejta. Por, këtu nuk mund të lihet pa përmendur se edhe muslimanët duhej të paguanin zekatin, një shumë që e paguanin vetëm muslimanët. E thënë ndryshe, xhizja e të krishterëve balanconte zekatin e muslimanëve. Pavarësisht se politika e sulltanit mbeti e pandryshuar deri në mesin e shek XIX, popujt ballkanas ortodoksë, serbët, grekët e bullgarët e shfaqën veten pas pavarësisë së tyre. Sapo fituan autonominë më 1830, serbët ortodoksë masakruan dhe dëbuan gjithë muslimanët, qofshin serbë ose jo. Gjatë viteve të kryengritjes greke, grekët ortodoksë spastruan me tradhëti grekët muslimanë, që i patën bashkëudhëtarë në rrugën e tyre për liri. Pas fitimit të autonomisë më 1878, bullgarët përsëritën të njëjtën gjë. Por nuk mjaftoi kaq. Pasi formuan shtetet përkatëse, ata bënë çmos të zhduknin Perandorinë Osmane, dhe formuan me rradhë koalicione që të përmbushnin qëllimin e tyre. Sigurisht popullatat muslimane zhdukeshin. Kulmi arriti gjatë Luftërave Ballkanike. Sapo u formua Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, boshnjakët pësuan masakrime, ashtu si dhe shqiptarët në Kosovë, Mal të Zi dhe Greqi. . Kjo urrejtje e ortodoksëve ballkanas ndaj muslimanëve vazhdon edhe sot dhe pasqyrohet në qëndrimin politik të Shqipërisë me Serbinë e Greqinë, si dhe të Turqisë me Greqinë. Cfarë shpjegimi ka për këto shpërthime të urrejtjes? Sigurisht faktore nuk është politika e sulltanit, e nuk janë faktorë as muslimanët, por vetë këta popuj që me bëmat e tyre i nxorën në pah tiparet e veta Perandoria Osmane është një temë e parapëlqyer edhe në vendin tonë dhe ngjall gjithmonë debat. Është për të ardhur keq kur dëgjon të flitet për Perandorinë Osmane me terma penalizuese Ajo është kthyer në shënjestër ku gjejnë përgjigje të gjitha shqetësimet, prapambetjet dhe mangësitë tona, duke përdorë sloganan famëkeq "Fajin na e ka turku" Sigurisht këto janë përralla që nuk e kanë të gjatë, por të shqetëson fakti se kush janë ata që i flasin dhe ku gjejnë mbështetje.

*Ardit Muça
student në Universitetin e Tiranës*



OSMAN NURI TOPBASH NE MES TE VELLEZERVE TE TIJ SHQIPTARE



fjalën e tij shprehu respektin e pakufizuar për pritjen vëllazërore që i rezervuan qytetarët shkodranë dhe vuri në dukje se, në mes të popullit shqiptar dhe atij turk, është një lidhje e fuqishme e cila lidhet me bashkjetesën e këtyre dy popujve në Perendorinë e Lavdishme Osmane. Shqiptarët kanë dhënë një kontribut madhështor në historinë e kësaj Perendorie, sepse ato i dhanë asaj 40 kryemistra duke vënë themele të çelika për jetëgjatësinë e Perendorisë së Lavdishme Osmane. Ishin gjyshërit tuaj, vazhdoi miku i nderuar, që luftuan sup me sup në betejën legjendare të çanakalasë, ku pësuan humje armiq e Perendorisë dhe të Islamit. Ne kemi bashkëjetuar dhe në këtë mënyrë kemi lidhur përjetësi sht fatin e popullit turk me fatin e popullit shqiptar i cili do të jetë i lidhur përjetësisht. Këto ishin fjalë që dilnin nga zemra e një vëllau për vëllezerit e tij, të cilët e kanë fatin e jetës të përbashkët. Pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe njohja e të pranishmëve me botimet e shkrimtari bamires që njihet në të gjithë

botën islame dhe atë perendimore. Librat që u bënë të njohur gjatë këtij aktiviteti fetar-kulturor kishin tituj madhështorë si është edhe madhështore edhe vepra e tij në shërbim të çështjes Islame

Libra të tillë si; Muhamed Mustafa, Vakëfi Dhurimi dhe Shërbimi, Haxhi Ideal dhe Umreja, Tasavvufi ose Mistika Islame janë perla të vërteta të literaturës islame.

të cilat i shtohen botimeve të mëparshme të këtij vëllau të nderuar. Ajo që na bëri përshtypje është se të ftuarit nuk u larguan menjëherë, por u takuan dhe shtërnguan duart me bamirësin dhe shkrimtarin islam, Osman Nuri Topbash, duke treguar se ai tashmë është bërë pjesë e pandarë e jetës së qytetarve shkodranë. U ndamë nga ky mik i nderuar me dëshirën dhe shpresën e madhe për t, u pare përsëri në aktivitete të tilla Islame.

*Selim Gokaj
Shkodër, me 26 tetor 2007*

Me datën 26 tetor 2007, në sallën qendrore të kinema Milenium, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me shoqatën turke "Vakv Istanbul" organizuan nje veprmtari kulturore-fetare për nder të vizitës së mikut dhe vëllaut të shqiptarve, të nderuarit Osman Nuri Topbash i cili bëri vizitën e tij të rrallës në Shkodër. Pjesëmarrja masive e qytetarve shkodranë në këtë aktivitet, ishte një shprehje e qartë e respektit që gëzon ky bamires musliman i cili e ka venë pasurinë e tij në dispozicion të një mesazhi islam që përhapet nga medrezetë që rrezatojnë në shumë vende muslimane duke përfshirë edhe medrezetë kryesore në Shqipëri. Qytetarëte qytetit të Shkodrës e nderojnë në veçanti Osman Nuri Tabpash, sepse ky bamires i nderuar financo nga pasuria e tij medrezenë e vajzave dhe kohet e fundit, në rrezën e bamirësisë së tij, është vënë edhe medrezeja e djemve.

Të ftuarit në këtë aktivitet kulturor- fetar ndoqën me shumë vemedje fjalën e myftiut të Shkodrës, Ndiçim Sulejmani, fjalën e të nderuarit Osman Nuri Topbash dhe fjalën e përfaqësuesit, kordinatorit të shoqatës turke " Vakëf Istanbul në qytetin e Shkodrës, Shuajp Bashan.

Vizitori i nderuar nga vendi mik i Turqisë, në



Viti 1979 në historinë më të re botërore do të mbetet i shënuar si vit i rilindjes fetare të myslimanëve në botë në fund të shekullit XX pas një periudhe ngecjeje një shekullorë. Ky vit shënoi një kthesë të madhe në ndjenjat islame dhe se ishte katalizator i ringjalljes së ndjenjave të nëpërkëmbura fetare gjer në atë kohë të myslimanëve anëmbanë botës.

Viti 1979, isha në moshën 16 vjeçare, nxënës në vitin e parë të gjimnazit, kur si vetëtimë përshkroi globin jehona e ngadhënjimit të revolucionit islamik në Iran, me ç'rast u shemb dinastia mijëvjeçare në krye me shahun Reza Pahlavi si dhe ardhja e imam Homeinit në krye të revolucionit islamik si udhëheqës politik dhe shpirtëror i tij. Kjo më të vërtetë që ngjarje e madhe në botën islame dhe se shërbeu si pikënisje e rilindjes fetare islame pas gati një shekull stagnimi me rastin e përmbysjes së Perandorisë osmane në vitin 1923 dhe rrënjës pothuajse të tërë botës islame në kthetrat e pushtimeve kolonialiste. Slogani më i përhapur në atë kohë ishte "Allahu ekber, Homeini rehber" që do të thotë Allahu është i madh, Homeini udhëheqës, kjo klithje e fuqishme bëri jehonë në të katër anët e botës islame. Edhe pse doktrina shiite dallohet nga doktrina sunite, në këtë kohë ngadhënjimi i revolucionit islamik në Iran, shërbeu si inspirim i masave të shumta të nëpërkëmbura myslimane në tërë botën islame. Medoemos edhe kjo klithje e përmasave botërore u reflektua edhe në Kosovë, me ç'rast nxitu të ripërtëritjen e ndjenjave fetare në atë kohë edhe pse ishte koha e sundimit vetëqeverisës socialist të ashtuquajtur në atë kohë në ish Jugosllavi.

Pionier i ripërtëritjes së këtyre ndjenjave fetare në Prizren ka qenë myftiu i fundit Hafiz Safet Basha (Allahu e shpërbleftë me xhenet) i cili ndërmori një iniciativë për atë kohë e panjohur në mesin tonë gjer atëherë, organizoi tubimet javore në lokalet e Vakëfit (Myftinisë) të Prizrenit me të rinjtë entuziast besimtar të pakët në atë kohë. Tubimet javore rinore zgjatën pothuajse 1 vit të plotë, me ç'rast edhe numri i të rinjve musliman shtojte, edhe pse pothuajse mbaheshin në gjysmëlegalitet larg syve të opinionit. Temat që shoshiteshin dhe trajtoheshin ishin kryesisht fetare por nuk anashkaloheshin edhe problemet politike, sidomos pozita e myslimanëve në shtetet socialiste (komuniste) të asaj kohe, e sidomos pozita dhe problemet e myslimanëve në hapësirën e ish Jugosllavisë, në Kosovë, Maqedoni, Sanxhak, Bosnjë e kështu me rrallë. Këto takime të rregullta javore vazhduan gjer në vdekjen e marshall Titos kryetar i përjetshëm i ish Jugosllavisë dhe udhëheqës i revolucionit socialist nga viti 1945 e gjer në vitin 1980. Pas vdekjes së Titos me kërkesë të myftiut, i cili posedonte një urtësi të rallë dhe një strategji veprimi të duhur, edhe pse sado kudo kishte një liri fetare në atë kohë, por ajo ishte nën kontroll dhe mbikëqyrje të rreptë të shërbimit të sigurimit të

RILINDJA FETARE

brendshëm (UDB-a).

Myftiu ishte largpamës në atë drejtim dhe nuk kishte dëshirë që neve të rinjve të na ndodhë ndonjë befasie eventuale e pakëndshme në atë drejtim. Merita e tij e pamohueshme ishte vënia e bazamentit të kësaj rilindjeje fetare rinore dhe e cila më tutje vetëm sa e përforcohej më shumë. Pas kësaj aksioni i parë i ynë konkret rinor ishte renovimi dhe rregullimi i tërësishëm i xhamisë së Myderisë Ali efendisë, e cila gjendet përball kishës katolike, dhe se një kohë gjatë ishte e braktisur dhe ka



shërbyer si depo në atë kohë dhe më parë që e djegur. Me aksionet tona vullnetare dhe ndihmën materiale të besimtarëve arritëm ta kthejmë xhaminë në shërbim të vet, dhe se kjo ishte xhamia e parë në Prizren e rinovuar pas një periudhe të gjatë mbi 30 vjeçare të stagnimit të aktiviteteve fetare. Aktiviteti ynë i ardhshëm vazhdoi tani në xhaminë rinovuar me ç'rast organizonim takimet tona, e sidomos gjatë netëve të Ramazanit, ku vazhdoi ngritja dhe inspirimi ynë për klauzolën islame. Në vitin 1983 u kurdis procesi i montuar në Sarajevë kundër grupit të intelektualëve mysliman në krye me udhëheqësin e saj Alia Izetbegoviç, i cili proces bëri jehonë të madhe në tërë ish Jugosllavinë, si dhe në arenën ndërkombëtare të asaj kohe. Ky proces shërbeu si katalizator i ringjalljes së ndjenjave fetare të masave të gjera në Bosnjë, e më vonë gjatë viteve 90-ta edhe të ndjenjave kombëtare të tyre me

rastin e shpërbërjes së ish Jugosllavisë, dhe se ky grup i intelektualëve u vu në krye të lëvizjes dhe rezistencës së armatosur kundër agresionit serbomadhi mbi Bosnjën e Hercegovinën. Gjatë kohës sa zhvillohej procesi i montuar kundër grupit të intelektualëve mysliman, isha në shërbim ushtarak, dhe se me vëmendje të madhe e përcillja nëpërmes shtypit të atëhershëm dhe mjeteve të informimit, pasi në atë grup ishte edhe shoku im nga Sarajeva nën hetime, por pasi që ishte i moshës jomadhore u lirua pas 30 ditëve të kaluara në paraburgim. Vend tubimi i mbledhjes së shkëndijave të para të ndjenjave fetare ka qenë mesxhidi i Tabakëve në Sarajevë nga i cili lindi, inspiroi, zhvilloi dhe vazhdoi i tërë ky aktivitet për ringjalljen e ndjenjave fetare dhe kombëtare të boshnjakëve, përkundër asaj në Kosovë në të cilin aktiviteti kombëtar shqiptar zhvillohej në një kah të kundërt me atë boshnjak, pasi që tek ne në Kosovë aspak nuk merrej parasysh e bile bile edhe luftohej feja, pasi që i tërë brumi i rilindjes kombëtare ishte sajuar në baza dhe ide marksiste leniniste, enveriste e titiste e që të gjitha këto teza ishin kryekëput antifetare.

Sa për ilustrim do të cek bisedat politike që janë zhvilluar në burgun e Foçës viteve tetëdhjeta në mes delegacionit boshnjak dhe shqiptar të krerëve politik të asaj kohe që i vuanin dënimet me burg në atë kohë si shqiptarët ashtu edhe boshnjakët. Po e paraqes këtu vetëm një rezymë të bisedës nga e cila lexuesi mund të kuptojë thelbin e saj:

"Shqiptarët janë popull mysliman, dhe se kjo është arsyeja kryesore që ne përkrahim luftën dhe përpjekjen e juaj për liri kombëtare. Shqiptarët u shqetësuan pa masë me këto fjalë. Kryesuesi i delegacionit shqiptar u përgjigj se në tezat e juaja janë disa qëndrime të gabuara, sepse sipas mendimit të tyre, religjioni ka luajtur rolin negativ në historinë e popullit shqiptar dhe se i ka shërbyer okupatorit. Religjioni sipas tyre është i tejkaluar dhe i panevojshëm për popullin shqiptar në luftën e tyre për lirinë dhe të drejtat kombëtare, përfundoi kryesuesi i delegacionit shqiptar. Atëherë ju jeni i vetmi popull në planetë që mund të jetojë pa fe, por mendimi ynë është se shumica e popullit shqiptar nuk e përkrah këtë mendim, iu përgjigj kryesuesi i delegacionit boshnjak, vetëm marksizmi leninizmi ka prurë progres popullit tonë, u përgjigj kryesuesi i delegacionit shqiptar. E po mirë atëherë, ju vazhdoni me rrugën e juaj, ajo është mendimi i juaj, por ne edhe më tutje do të përkrahim luftën e popullit shqiptar për liri dhe barazi. Biseda përfundoi dhe ne vazhduam gjatë gjithë kohës të jemi miqtë të mirë". Në përfundim të kësaj qasjeje do të konstatoj se të dyja këto rilindje, si ajo kombëtare ashtu edhe fetare janë të gërshtuara mes vete aq shumë dhe se paraqesin një trup të vetëm, ashtu siç janë të mishëruar në mes vete muskujt dhe eshtrat në konstruksionin e trupit njerëzor.

Faik MIFTARI

A është shamia sulm mbi vlerat demokratike?

Nexhat Ibrahim



Njerëzit fisnikë ndaj grave të tyre janë bujarë dhe të kujdesshëm. Përçmimi dhe dëmi ndaj tyre mund të ndodhë nga njerëzit me karakter të ulët dhe të dëmshëm. Lëndimet, sprovat dhe vuajtjet janë reale në histori dhe duhet të shërbejnë si mësim që mos t'i përsërisim gabimet dhe mëkatet.

Pas sprovave dhe vuajtjeve njeriu çlirohet nga prangat e mosnjohjes dhe zemra e njeriut më qartë se deri atëherë e njofton bukurinë e mirëfilltë të fesë së vërtetë.

Ndaj, muslimanja e njofton vetë fenë e saj dhe nuk pretë urdhëresë prej kryetarëve shtetërorë që t'ju flasin për fenë e tyre dhe të drejtat e tyre. Muslimanja në përgjithësi dhe ajo shqiptare në veçanti nuk kërkon dhe nuk pretë vendim dhe leje të Fatmir Sejdiut, Merkelit, Sarkozit, Bushit, Putinit e shumë të tjerëve si ta njohë dhe mësojë fenë e saj, a duhet të bajë shami, apo duhet të zhveshet. Nëse jomuslimanja ka të drejtë të zgjedh mënyrën dhe llojin e veshjes, edhe muslimanja ka të drejtë në zgjedhjen e veshjes dhe mënyrën e llojin e saj.

Për pozitën e femrës në Islam është shkruar, folur e përfolur mjaft. Pa marrë parasysh çka është folur deri tash, sërish duhet të flitet për rolin dhe rëndësinë e saj në shoqëri dhe familje në kohën e ngatërrimit të vlerave dhe pavlerave. Mendimet tendencioze dhe abuzive për pozitën e femrës në Islam shpesh herë gjejnë hapësirë si në botë ashtu edhe te ne. Jemi dëshmitarë të abuzimeve ndaj

femrës muslimane në shumë vende të botës, por edhe në Shqipëri, Kosovë e vende të tjera. Fanatikë shekullaristë, antimuslimanë, në vazhdimësi provokojnë ndjenjat muslimane, duke atakuar vlerën më të madhe, femrën, e cila me veshjen e saj ngjason në perlën e cila strehohet në guacën e saj.

Intelektuali i njohur musliman, Zijauddin Serdari, duke e komentuar aferën e shamisë në Francë, me gjysmë ironi thotë: **Thus, a French woman with a scarf is chic, but a Muslim woman with a scarf is a threat to civilization!** "Ndaj, francezja me shami është shik (simpatike), kurse femra muslimane me shami është kërcënim për qytetërimin."

Pse ky panik?, pse ky alarm?, për shkak të femrës muslimane me shami në kokë? Përse gjithë kjo rrëmujë për femrën muslimane me shami?

Ata thonë: Dëshirojnë që femrën muslimane ta çlirojnë nga mesjeta? Por, përse, nga kush në mesjetë? Ata thonë: Ta çlirojnë nga feja dhe nga bindja ndaj Zotit!

Mirë, ta çlirojmë nga feja dhe nga bindja fesë islame, por çka ofroni si zëvendësim në vend të fesë islame dhe të shamisë?

Ata thonë: Lumturinë!

Ohoho! Ç'është lumturia?, kujt i thoni "lumturi", zotëri? Heqjes së shamisë dhe zhveshurisë? Absurd!

Është i njohur rasti i një artisteje franceze, e cila para kamerave televizive ka prezantuar një skenë plotësisht e zhveshur. Në një moment u bë histerike, bërtiti në drejtim të artistëve dhe regjisorit: "O qenë, ju nuk jeni njerëz, ju nuk dëshironi me ne femrat tjetër gjë pos trupit tonë, në mënyrë që të bëheni milionerë në kurrizin tonë!" Pastaj u kthye duke qajtur.

Tërë kjo fletë për vuajtje të mëdha, të cilat me perfiditet fshehen, por këto vuajtje megjithatë janë të qarta.

Për femrat e zhveshura shekullaristët thonë se janë më moderne, më të qytetëruara dhe më të kulturuar se femrat muslimane, por mallkuar qoftë ai modernizëm, ai qytetërim dhe ajo kulturë që për vlerë e quan zhveshurinë dhe kënaqësinë e krevatit.

Me apo pa dëshirë, duhet të pranojmë se femra sot është bërë mjet i mirë për sendërtimin e interesave të meshkujve dhe kompanive mafioze. Me të drejtë Evropë-perëndimi e atakon femrën muslimane sepse në të sheh pengesën e fundit dhe të vetme, barrikadën e fuqishme kundrejt egoizmit dhe pangopësisë së tyre.

Bota moderne pretendon se ka arritur ta barazojë femrën me mashkullin, por harrojmë se bota moderne e barazoi femrën në atë që nuk është femërore. Modernja e bëri femrën objekt publik admiring dhe shpërdorimi, ia mori personalitetin, vlerën femërore dhe vetëmohimin e saj. Nga pozita e nënës, e zonjës dhe e menagjerit familjar, femra u transformue në manekene, fotomodele, në objekt bordelesh, në një "kafshë të mirë" për të plotësuar afinitetet dhe obskurantizmin mashkullor.

Deri sa në Islam femra ishte lule në mes shumë luleve në kopsht, femra në qytetërimin modern u bë lule që hedhet në rrugë, që nëpërkëmbet dhe përçmohet.

Por, për këtë arsye, ne muslimanët nuk i urrejmë të tjerët por e urrejmë të keqen që serviret si vlerë dhe është rrënjësor në kokat dhe qenien e modernistëve.

Është e qartë se shamia nuk është sulm mbi vlerat demokratike, sepse sulm mbi këto vlera është zhveshuria dhe çoroditja morale e motivuar me interesa politike dhe ekonomike.

Vallë, do të kthjellen kokat e qeveritarëve dhe intelektualëve tanë dhe angazhimin e tyre do ta orientojnë drejt të keqes e jo drejt shkeljes së të drejtave më elementare individuale dhe fetare në shoqërinë tonë në Kosovë dhe në trojet shqiptare.

DEKLARATE

Shoqata Bamirëse Islame Shkodër, Shoqata e Intelktualëve Kultura Islame dega Shkodër, Klubi Kulturor Drita dhe Dega e Forumit Musliman Shkodër, shprehin shqetësimin e tyre dhe reagojnë ndaj projektit të qeverisë demokratike për të vendosur në kartën e identitetit të qytetarve shqiptarë figurën e shenjtores katolike, Nënë Tereza duke i dhënë një goditje të rëndë karakterit laik të shtetit shqiptar. karakter që është i përcaktuar qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shoqatat muslimane të qytetit të Shkodrës mbështesin qëndrimin e Këshillit të Përgjithshëm të KMSH dhe të kryetarit të këtij Këshilli, Ahmet çausi, gjithashtu në mbështesim deklaratën e Forumit Musliman Shqiptar, të cilët, me deklaratat e tyre mediatike, protestuan haptas në mënyrë publike kundër vendosjes së figurës së shenjtores katolike, Nënë Tereza në kartën e identitetit të qytetarve shqiptarë.

Ne jemi të bindur se qeveria demokratike po e përdorë figurën e Nënë Terezës me pikësynimin për ta kthyer atë në një figurë mitike fetare duke u përprekur t, i japin Shqipërisë një pamje të krishterë. Në këtë kuadër duhen pare festimet që u organizuan në dhjetëditshin e kësaj zoje të nderuar, të cilat kulmuan me vendosjen e një busti të saj që ka pamjen e qartë të kryqit në aeroporti e Nënë Terezës, sikur të mos mjaftonte emri që ka ky aeroport. Shoqatat muslimane në Shkodër i kujtojnë qeverisë demokratike se kushtetuta kërkon qartë që të respektohen të gjitha fetë dhe jo të ketë njëanshmëri në trajtimin e tyre si është rasti e dhënies së kartës së identitetit të një ngjyre të krishterë. Propoganda mediatike dhe shtetërore, që përpiqet të na bindë se Nënë Tereza është bamirëse është thjesht abusive, sepse ajo është një misionare bamirëse dhe misioni i saj është një investim direkt për qendrën e religjionit të cilit ajo i përket dhe është pikërisht kjo qendër që e lumturoi dhe po e shenjtëron për kryjen me sukses të misionit që kjo qendër ia pat ngarkuar.

Përprekjet që po bëhen për të çuar shqiptarët në Evropë me kartë të krishterë, është në kundërshtim me pohimin e presidentin Bush dhe të eurodeputetes Doris Spak, që kanë theksuar se Shqipëria ka popullsi me shumicë muslimane e cila nuk i pengon për t, u integruar në Evropë. Veprimi që po bën qeveria shqiptare duke u përprekur t, u jape qytetarve të saj një kartë, ku është vendosur figura e një shenjtoreshë katolike i jep një goditje të ashpër tolerances fetare në Shqipëri dhe u heq maskën e hipokrizisë atyre pushtetarve që flasin për tolerance fetare, ndërsa në terren veprojnë ndryshe. Në Itali, ku ka selinë qendra botërore e krishterizmit, Vatikani, qytetarët kanë një kartë identiteti që nuk ka simbole fetare por ka një flamur Italian dhe një flamur të Evropës së Bashkuar, duke na bërë të dyshojmë për një prapavijë fetare në hartimin e një karte të tillë për qytetarët shqiptarë Shoqatat muslimanë të Shkodrës e quajnë shumë të rëndësishëm një deklaram mediatik që duhet të bëjë Kryesia e KMSH për kartën e identitetit, sepse çështja e kartës ka të bëjë me mbrojtjen e identitetit të muslimanëve shqiptarë për të cilin kryesia e KMSH, është e obliguar nga statusi i KMSH. Duke dale me një deklaratë të tillë, do t, u pritët rruga mediave që spekullojnë duke deklaruar se Kryesia e KMSH është në një linjë me qeverinë demokratike për një kartë identiteti me figuren e një shenjtoreshë katolike.

Ne i bëjmë thirrje qeverisë demokratike që të rishikojë projektin e kësaj karte dhe të jape në media një model të ri të kartës së identitetit për qytetarët e saj, e cila të respektojë karakterin laik të shtetit shqiptar që është i përcaktuar qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shoqata Bamirëse Shkodër

*Shoqata e Intelktualëve Kultura Islame
Forumi Musliman Shqiptar dega Shkodër*

Klubi Kulturor Drita

SHKODER ME 3 NENTOR 2007

KURBAN BAJRAMI ESHTË PARA KRISHTLINDJEVE Z. VETO SURROI

Në një deklaratë mediatike të ditëve të fundit, anëtari i Grupit të Unitetit që përfaqëson qeverinë e Kosovës për zgjidhjen e statuatit të Kosovës dhe njëkohësisht kryetar i partisë ORA deklaroi se Pavarësia Kosovës do të jetë fakt i kryer para Krishtlindjeve. Që Pavarësia e hapësirës shqiptare që quhet Kosove do të realizohet është e qartë dhe nuk ka të bëjë me dëshirën e Surroit, sepse janë qendra të tjera ato që e kanë planifikuar Pavarësinë e Kosovës dhe pasojat zinzhir që do të ketë Pavarësia e Kosovës në Rajonin e Ballkani. Ajo që na bën përshtypje është se Krishtlindjet nuk janë pike referimi për qytetarët e Kosovës që ka një popullsi absolute muslimane. Mund të përdoret si pike referimi një festë publike dhe jo një festë fetare që në Kosovë e ka të veten një minorancë absolute. Z. Surroi mud t, i ishte referuar festës së Kurban Bajramit me që paska pasur dëshirë të vendosë kufijt e Pavarësisë së Kosovës me festa fetare, sepse Kurban Bajrami është festa e muslimanëve që përfaqësojnë thujse gjithë popullsinë e Kosovës. Por, duket se Veton Surroi, që është politikani më i pasur në Kosovë, vuan nga sidromi "I fesë së të parëve" i cili me ose pa dëshirën e tij behet pjesë e deklaratave të tij politike duke harruar se ato vende që kanë "fenë e të parve tanë" po i vënë shkopinj nën rrota Pavarësisë së Kosovës dhe po shprehen hapur në media kundër Pavarësisë së Kosovës.

Kurse, shtetet që kanë fene islame, e cila duket se Surroi e shumë të tjerëve si Surroi po u rri shtërnuar janë, ato që do të votojnë në bllok për Pavarësinë e Kosovës, sepse për shtetet muslimane kosovarët janë vëllezërit e tyre. Diplomacia shqiptare tashmë e ka marrë vesh se kush janë mbështetësit e vërtetë të Pavarësisë së Kosovës dhe po merr kontakte me Konferencen Islamike duke u bërë thirrje vendeve të kësaj konference që të përkrahin Pavarësinë e Kosovës.

Prandaj z. Vton Surroi do të dëshronim të të kujtonim se Pavarësia E Kosovës do të vijë para Kurban Bajramit i cili është 5 ditë para Krishtlindjeve

Selim Gokaj Shkodër, me 8 nëntor 2007

TAKIM MIDIS SHOQATAVE MUSLIMANETE SHKODRES DHE MYFTINISE SE QYTETIT TE SHKODRES

Me kërkesën e shoqatave muslimane të qytetit të Shkodrës, myftinia Shkodër priti në ambjete të kësaj myftinie drejtuesit e këtyre shoqatave të cilët parashtruan disa probleme që kishin të bënin me shqetësimet që lidhen me çështje që kanë të bëjnë me fenë islame në hapësirat e qytetit të Shkodrës dhe më gjërë. Myftinia Shkodër përfaqësohej nga myftiu Imam, Ndriçim Sulejmani, teologu Arben Halluni, administratori Blendi Alushi dhe H. Fejzi Zaganjori. Ndërsa shoqatat përfaqësoheshin nga H. Vehbi Dani, kryetar i Shoqatës Bamirëse Islame Shkodër, Isa Tafili dhe Nexhat Loku, nënkryetar dhe sekretar i kësaj shoqate, Ferit Hafizi, Selim Gokaj dhe Artur Halili, përkatësisht kryetar, nënkryetar dhe sekretar të shoqatës së Intelktualëve "Kultura Islame, dega Shkodër, Drejtori i Klubit Kulturor Drita, Bujar Shehu dhe kryetari i degës së Forumit Musliman Shqiptar, Eljaz Kalçi. Në këtë takim u diskutua çështja e kartës së identitetit e cila po merr pamjen e një karte të krishterë, sepse aty po tentohet të vendoset nga qeveria demokratike figura e shenjtores katolike e Nënë Terezës, kartë që, u tha gjatë këtij takimi, se cënon karakterin laik të shtetit shqiptar dhe cënon direk identitetin e shumicës së popullsisë shqiptare që është e besimit musliman. Shoqatat ishin për një konferencë shtypi për këtë prolen, ndërsa myftina tha se do të veprojmë në një linjë me KMSH.

Ghithashtu në këtë takim u diskutua për çështjen e varrezave "Komane", për mënyrën si janë bërë zgjedhjet e këshillit të myftinisë dhe së fundi u diskutua çështja e xhamisë së Dudasit.

Të dy palët ranë dakort që të vazhdojnë takimet në mes të tyre duke e motivuar këtë me linjën e njëjtë islame që kanë, e cila ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të muslimanëve në Shkodër dhe më gjerë.

Selim Gokaj Shkodër me 22 tetor 2007

LUFTA KUNDER TERRORIZMIT TASHME ESHTË NJE METAFORË ERREME

Gjatë pesë viteve "Lufta kundër terrorizmit" është shfaqur si një metaforë e rreme, që ka çuar në një politikë shkatërruese. Fjalë mashtruese janë përdorur për të nisur luftën e vërtetë në disa fronte si :Irak, Gazë, Liban, Afganistan e Somali, ku janë vrarë mijra civilë të pafajshëm dhe miliona njëzëz të tjerë janë të kërcënuar në të gjithë botën. Fatkeqësisht publiku amerikan e ka pranuar metaforën e luftës, si përgjigje e dukshme për 11 shtatorin në mënyrë jo publike. Edhe tashti që është pranuar publikisht se lufta kundër Irakut ka qenë gabim serjoz, "Lufta kundër terrorizmit" mbetet përsëri kuadri ku përfshihet politika amerikane. Edhe shumica e demokratëve janë të detyruar të rrijnë në këtë linjë sepse ndryshe mund të cilësohen si të dobët në mbrojtje. Por mbështetja për një kohë të gjatë e luftës kundër terrorit e bën këtë luftë vetë shkatërruese.

Nga natyra e vet, lufta shkakton viktima të pafajshme dhe kjo është e dukshme kur lufta bëhet kundër terroristëve që përpiqen të ruajnë të fshehta vendqëndrimet e tyre.

Shkatërrimi, rrënimi dhe asgjësimi i civilëve shkakton zemrim dhe indinjatë në bashkëitë dhe familjet etyre dhe si pasojë nxit mbështetjen për terroristët. Të mos harrojmë se terrorizmi është abstraksion që veti e lëvizjeve politike që shfrytë zoknë taktikën terroriste. Al- Kaeda,

Hamasi Hesbullahu janë forca të ndryshme, por lufta globale e presidentit Bush na pengon që t, i dallojmë dhe të sillemi ndaj tyre si duhet. Lufta kundër terrorizmit e bën të pamundur marrveshtjen me Sirinë dhe Iranin që janë shtete që mbështesin terrorizmin. Theksi në aksion ushtarak të luftës kundër terrorit e rrit kërcënimin terrorist dhe e vështirëson punën agjensive të informimit.

Osama bin Laden dhe Ajman Al Zavari janë në liri dhe ne duhet të përqëndrohemi tek ata në se duam t, i gjejmë në se dusem të pengojmë sulmet si ata në Angli. Lufta kundër terrorit ngul një pykë në mes nesh dhe atyre, ku ne jemi viktimat, kurse ato ekzekutorët.

Pjesa tjetër e botës vë re një hendek në perceptim duke dobësuar kështu pozitën e SHBA

Në arenën ndërkombëtare. Duke i marrë së bashku këto faktorë konstatojmë se lufta kundër terrorizmit nuk mund të fitohet, sepse lufta pa fund kundër një armiku të padukshëm sjell dëm për autoritetin tone dhe për shoqërinë tone. Me ndikimin amerikan ekziston rreziku që të rrëshqitet në ciklin e keq të përshkallzimit të dhunës, e cila mund të shmanget vetëm në se amerikanët pranojnë se lufta kundër terrorizmit është një metaforë e rreme.

XHORXH SOROS

HAFIZ YMER BAKALLI -DIJETAR DHE PATRIOT

Ndonëse kanë kaluar 50-vjet, ai ka qenë dhe është në mendjen e shumë bashkë qytetarëve shkodranë dhe në të gjitha hapësirat e tjera shqiptarej. Veçanarisht, kujtohet nga besimtarët e xhamisë së Rusit të Vogël dhe të xhamisë Fushë-Çelë, që e dëgjuan dhe e respektuan Hoxhën e tyre të nderua. r Devotshmërinë, këshillat, thjeshtësinë, diturinë dhe kulturën e tij të gjërë, ne e kujtojmë me nderim dhe vlerësim të lartë. Për veprimtarinë e Hafiz Ymer Bakallit, kanë shkruar në librin "Në kujtim të brezave", i ndjeri, Faik Luli, e zotërinjtë Islam Dizdari e Nexhmi Bushati, si dhe në librin "Institucionet Islame dhe Hoxhallarët e Shkodrës", të Z. Ismail Balës. Hafiz Ymer Bakalli, lindi me 05. 07. 1870 në lagjen Rus i vogël të qytetit të Shkodrës, në një familje shkodrane me tradita të vyera qytetare, ku u rrit dhe u edukua me një edukatë të shëndoshë morale dhe islame Hafizi, që në fëmijëri, u dallua në mes të shokëve për shkathtësi dhe inteligjencë, gjë që tëhoqi vëmendjen e Haxhi Jusuf Kelemndit dhe të Mollah Muho Krajës dhe, pranë mejtepeve të tyre hafizi i ardhshëm mësoi Kuranin e madhnueshëm dhe bazat e turqishtes dhe arabishtes Prindëri e dërgojnë në Stamboll për të studjuar ku ndjek medrezën dhe pastaj universitetin ku ai ngre një godinë madhështore të dijeve të pafundme Pikërisht, në kryeqytetin e Perandorisë Osmane, ku ishin grumbulluar shumë dijetarë të shquar, Hafiz Ymer Bakalli, djaloshi i ri nga Shkodra, i hyri studimeve dhe shumë shpejt tërhoqi vëmendjen e myderrizve. Ata panë tek ky student aftësitë e rralla dhe mundësi të mëdha studimi. Profesorët e tij mahnitën nga përgatitja e tij me nivel të lartë. Po ashtu edhe gazetata turke paten shkruar dhe e paten cilësuar si student shqiptar me cilësi të rralla e me prirje për tu bërë një dijetar i madh. Në Stamboll mëson mire turqishten, arabishten, persishten, frëngjishten dhe anglishten Ai njohu mirë historinë dhe kulturën e vendeve të lindjes e Perëndimit. Mori titullin Hafiz, sepse mësoi përmendësh Kur-anin e Madhërueshëm dhe merr diplomën me madhësi 50X70cm që familjarët e ruajnë si relike të rralla të vatrës tyre. Ai vazhdoi e përfundoi me sukses të plotë studimet e larta teologjike, Profesorët turq i propozojnë të vazhdojnë një fakultet të dytë, atë të logjikës dhe psikologjisë.

Natyrë e tij ishte e tillë që punën e filluar e çonte deri në fund! Në biografinë e tij ai shkruan: "Kam mbaruar studimet e larta në Turqi në vitin 1905". Kjo aftësi, kjo përgatitje, ky talent me logjikë argumentuese, ky dijetarë i ardhshëm vlerësohet dhe emrohet me punë në Stamboll, professor në shkollën normale turke, gjë që e pasqyron në biografinë e vet. Në Stamboll, si professor, të bindë se e meriton plotësisht atë titull. Ai është studjues dhe shpjegues i problemeve të thella fetare, lidhur me ajetet e Kur-anit dhe veçanarisht të problemeve ligjore të së drejtës civile. Me 1907, kreu studimet pasuniversitare në Universitetin e famshëm të AL-AZHIN të Kajros në Egjipt. Si i pangopur me dijet që kishte, mbaron edhe akademinë ushtarake, diplomën përkatëse familjarët e ruajnë, dimensioned e së cilës janë 25X50 cm. Pastaj ai emrohet Allaj "Myfti" (Myfti i madh) në një rregjiment ushtarak po në Stamboll. Krahas



detyres fetare, ai mori pjesë edhe në luftimet me të cilat u përball rregjimenti i tij, ku edhe plagoset, dhe zihet rob e pastaj i internohet nga anglezët në Lahore të Pakistanit, e më vonë në Java të Indonezisë. Hafiz Ymer Bakalli, rreth viteve 1918 kthehet në atdhe, në qytetin e lindjes, dhe menjëherë fillon ushtrimin e detyres fetare, duke iu kushtuar çështjes së përhapjes dhe propagandimit të fesë islame në bashkpunim me Hafiz Ibrahim Repishtin, Jusuf Karakaçin, Hafiz Muhamet Bekteshin, në lidhje të ngushtë me Myftininë Shkoder, për përforcimin e traditave fetare, besimin te Zoti i madhërueshëm dhe vlerësohet si një nga hoxhallarët më në zë, për argumentimet bindëse që shqetësojnë xhematin, pa harruar të merret me studime të mëtejshme. Fakti që Hafiz Ymer Bakalli ishte një studjues i palodhur, dhe tepër këmbëngulës në punën e tij si lexues i literaturës fetare, filozofike, shkencore, turke, arabe e persiane tregojnë, madhështinë këtij personaliteti të madh islam. Ai i hyn shkrimeve, ku familjarët dëshmojnë se ka lënë dorshkrime, kopjime me dorë, apo shënime të tij ndër libra. Një ndër tre librat e tij, titullohet "Argumentet e të devotshmet ndaj atyre që kujtojnë Allahun", shkruar në vitin 1919 Megjithate, këto nuk e pengojnë Hafiz Ymerin të kryejë edhe detyra të tjera si: mësuesit, imamit, myderristit dhe vaizit. Ai emrohet në Medrezën e Re të Shkodrës, ku përkrah Hafiz Ibrahim Kadukut e Sali Efendi Myftisë punuan për arsimimin e nxënësve me arsimim fetarë e kulturor. Ai emrohet dhe vaiz në xhaminë e lagjes Rus i Vogël, në vitin 1932 dhe imam në xhaminë e Fushë Çelës në vitin 1940 dhe në vitin 1952 vaiz i qytetit të Shkodrës. Në këtë xhami, ai kujtohet si një imam dhe vaiz fjalë pak dhe bindës. Ligjeratat e tij ishin shumë të qarta e me logjikën e shëndoshë të një dijetari të formuar, permes librave dhe përvojës së gjatë të jetës. Ishte biblioteka e tij e pasur me libra fetare, filozofike e artistike, për të bërë të mundur që

ligjeratat e tija të ishin të një niveli të lartë. Ende të pashlyera janë në kujtesën e Sheh Faik Qazim Hoxhës, momentet kur Hafiz Ymer Bakalli përgatiti kumtesën e vet për qëndrimin ndaj "Kadrijanizmit" të cilën ia dërgoi universitetit të famshëm AL-AZHIN të Kajros. Meqë ishte pritur me interesim të madh për argumentat bindëse që e shoqëronin, ai mori dhe çmimin e dyte. Hafiz Ymer Bakalli përgatiti kuadro fetarë të cilëve shkodra dhe besimtarët e saj muslimanë nuk ua ka kursyer kurrë respektin për vlerat që ata kanë treguar. Hafiz Ymer Bakalli, me armë në dorë, merr pjesë në luftën e Koplikut, krahas shumë patriotëve të tjerë të qytetit të Shkodrës me rrethina. një ndër të cilët që vlen të përmendet i ndjeri e i respektuari Nuh Bala.. Si antifashist që ishte, Hafiz Ymeri, në vitin 1939, nuk dënjojti të bashkohej me grupin që i dolën përpara të porsaardhurve si pushtues të tokës mëmë. Ndërsa në vitin 1944, si antikomunist që ishte, u bëri thirrje pjesmarrësve të brigadës 27-sulmuese, të grumbulluar në oborrin e xhamisë Fushë Çelës të mos shkonin në Kososvë, për të rritur shkallën e pesekucionit titist ndaj kosovarëve. Hafiz Ymer Bakalli, i bindur për furtunën komuniste që do të fryente edhe në Shkoder me rrethina, u bënë thirrje Sylço

Bushatit me të birin, Xhelalin, dhe Jup Kazazit me vllazer që të largohen, për të mos patur atë fund që patën. Ky patriot në vijim të frymës humane që e karakterizonte, . Në vitin 1947, filloi lëvizja studentore antikomuniste, ku pjesmarrës ne mes shumë të tjerëve ishte edhe djali i madh i Hafiz Ymerit, Nihati, që në vitin 1950 arratiset për ti shpëtuar rrezkut komunist dhe sot është në SHBA, Komunistët në vitin 1950 e burgosen së bashku me bashkshorten zonjën Emine dhe vajzën e tretë Nazife (Saraçi). Gratë, mbas tre javësh i liruan, ndërsa Hafiz Ymer Bakallin, e degdisën në kampin famëkeq të Tepelenës. Nazifja, e bija e Hafizit, insistoi me forcë të zëvendësonte të atin, por Abdyl Bajraktari e largon me forcë duke i thënë "Ik se ty të mbysin!"

E ndjera znj. Emine së bashku me Nazifen, shkuan në shtëpi, por nuk gjetën njeri. Të dy fëmijët ende të parritur, Nezihanë e Myftin, (motër e vëlla), komunistët i kishin dëbuar nga shtëpia, strehuesit e të cilëve u bënë dajat e tyre. Dhëndërrit i tretë, Xhafer Jahja i cili pranoi të rrezikojë e ti marrë në shtëpinë e tij. Pas lirimit, Hafiz Ymer Bakalli u bashkua me fëmijët e vet, tek streha fisnike e të ndjerit dhe humanit guximtar, Xhafer Jahja. Në mbyllje të jetës së tij, Hafiz Ymer Bakalli, përfundoi tek nipi i tij po aq fisnik si i ati Mendtor Jahja. Korteshi i Hafiz Ymer Bakallit, i datës 02. 05. 1953, ka lënë gjurmë të thella në opinionin fisnik të qytetarve të Shkodrës! Ai pati besim tek All-llahu xh. sh. ndaj thoshte: "Të gjithë të mirat vijnë prej Tij!" Se sa i respektuar ishte, na bind së tepërmi edhe dekorimi që ju bë nga Presidenti i Republikës, në atë kohë, Z. Sali Berisha, me motivacionin:

"Klerik dhe patriot i ndershëm, që u shqua për veprimtarinë e tij fetare dhe patriotike për një shoqëri të lirë dhe të bashkuar".

Këshilli Bashkiak Shkodër e nderoi me dekorimin **"Qytetar Nderi"**

Shkodër me 7 nëntor 2007

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme
MISH HALLALL

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

Ju keni të drejtë të blini ku të doni por hallalli i vërtetë është vetëm tek market "ISMETI"

Adresa: Pranë teatrit "MICJENI"
Cel: 0692101893

EJANI TEK NE! FABRIKA E PERPUNIMIT
TE DRURIT

ILIRIA

me pronar Haxhj Ilir Muja (aktivist dhe bamirës Islam), ju afrojmë prodhime nga me të thjeshtat deri në dhoma gjumi. Shërbehet në kohë dhe me cilësi të lartë:

Prodhim dyer e dritare
Dhoma gjumi
Pajisje zyresh
Pajisje kuzhine
Dhoma fëmijësh

Pajisje për ambiente lokale
Te gjitha këto me çmime konkurruese dhe me transport të garantuar falas. Ejani në fabrikën tonë dhe do të mbetenit të kënaqur. Mund të kontaktoni me numrin e mobilit: 0692523565

